

V E N D I M
Nr.373, datë 26.7.1993

PËR KRIJIMIN E PREFEKTURAVE

Në mbështetje të nenit 1 të ligjit nr.7608, datë 22.9.1992 "Për prefekturat", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Krijohen 12 prefektura me shtrirje territoriale si më poshtë:

1. Prefektura e Shkodrës me qendër në Shkodër ku përfshihen rrethet Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë.

2. Prefektura e Kukësit me qendër në Kukës ku përfshihen rrethet Kukës, Tropojë dhe Has.

3. Prefektura e Lezhës me qendër në Lezhë ku përfshihen rrethet Lezhë, Laç dhe Mirditë.

4. Prefektura e Dibrës me qendër në Peshkopi ku përfshihen rrethet Dibër, Bulqizë dhe Mat.

5. Prefektura e Durrësit me qendër në Durrës ku përfshihen rrethet Durrës dhe Krujë.

6. Prefektura e Tiranës me qendër në Tiranë ku përfshihen rrethet Tiranë e Kavajë dhe Bashkia e Tiranës.

7. Prefektura e Elbasanit me qendër në Elbasan ku përfshihen rrethet Elbasan, Peqin, Gramsh e Librazhd.

8. Prefektura e Korçës me qendër në Korçë ku përfshihen rrethet Pogradec, Devoll, Korçë e Kolonjë.

9. Prefektura e Beratit me qendër në Berat ku përfshihen rrethet Berat, Kuçovë dhe Skrapar.

10. Prefektura e Fierit me qendër në Fier ku përfshihen rrethet Fier, Lushnjë e Mallakastër.

11. Prefektura e Vlorës me qendër në Vlorë ku përfshihen rrethet Vlorë, Delvinë e Sarandë.

12. Prefektura e Gjirokastrës me qendër në Gjirokastrë ku përfshihen rrethet Gjirokastrë, Tepelenë e Përmet.

II. Për krijimin e aparatit administrativ, prefekturave u jepen 180 punonjës.

III. Për fondin e pagave dhe shpenzimet administrative të prefekturave për vitin 1993 atyre u akordohet një fond prej 10 milionë lekë, i cili të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë të detajojë fondet për çdo prefekturë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi